



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

14-020/04-0216981/8 më 05. 09. 2018

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr.110 - 391, të dt. 25.02.2010, dhe të nenit 10 të Vendimit për kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve, 01 nr. 031- 112404, të dt.12.05.2014 Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e Komisionit për ndarje të subvencioneve në fushën e mirëqenies sociale.
- II. Anëtarë të komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
 1. Munavere Qerkezi - DMS, kryetare e komisionit;
 2. Valbona Osmani - Mehmetaj - DMS, anëtare;
 3. Lida Visoka - QPS, anëtare;
 4. Flutra Reçica - QMF, anëtare;
 5. Bilall Xani - OJQ "Nënë Tereza", anëtar.
- III. Detyrat e komisionit të cekur në pikën II të këtij vendimi, janë caktuar në dispozitat e neneve 11, 12 dhe 13 të Vendimit për kriteret dhe procedurën për ndarjen e subvencioneve, 01 nr. 031 - 112404, dt. 12.05.2014, dhe Rregulloren MF-NR- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
- IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij vendimi, komisioni i raporton Kryetarit të Komunës.
- V. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë Vendimi 01. nr. 14-020/04-0055102/18, dt. 07.03.2018.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

U dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Qendrës për shërbime me qytetarë,
- Në dosje.

Kryetari i Komunës
Shpend Ahmeti

